



## VENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

**Data e miratimit: 23 nëntor 2011**

**Numri i lëndës 2011-12**

**Z. Novica Trajkovic**

**Kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 23 nëntor 2011, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Antonio BALSAMO, kryesues  
Znj. Magda MIERZEWSKA, anëtare  
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare

Asistuar nga  
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor  
Znj. Leena LEIKAS, zyrtare ligjore  
Znj. Stephanie SELG, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit me 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa ishte regjistruar më 21 prill 2011.

### II. FAKTET

2. Faktet e rastit, siç janë paraqitur nga parashtruesi i ankesës, dhe siç shihen prej dokumenteve në dispozicion të Panelit, mund të përmbliidhen si në vijim.

3. Rreth orës 06:00 të datës 23 shtator 2009, policët e EULEX-it pa ndonjë njoftim paraprak kanë thyer dyert e shtëpisë së parashtruesit të ankesës dhe kanë kryer bastisjen e shtëpisë. Parashtruesi i ankesës pohon se gjithçka ishte rrëzuar dhe shumë gjësende në shtëpi dhe përreth ishte dëmtuar.
4. Gjatë bastisjes së shtëpisë, parashtruesi i ankesës ishte shtyrë për dysheme, ishte lidhur me pranga dhe ishte keqtrajtuar fizikisht edhe pse i kishte thënë policisë se ai nuk ndihej mirë dhe se kishte pasur një operacion në tru disa muaj më herët. Pas ardhjes së ekipit të ambulancës së EULEX-it më vonë, dyshohet se kishin vërtetuar se ai kishte tension të lartë të gjakut. Vetëm atëherë policia ia kishte hequr prangat.
5. Parashtruesi i ankesës pohon se policët kishin drejtuar armët e tyre drejt anëtarëve të tij të familjes, përfshirë dy fëmijët e tij, dhe se ai dhe djali i tij ishin sulmuat fizikisht nga Policia e EULEX-it. Djali i tij dyshohet se ishte shqelmuar në gjoks dhe bark, ishte prangosur dhe ishte mbajtur i lidhur në dysheme për nja gjysmë ore përderisa kokën e kishte të shtypur për dysheme. Përpos kësaj, policia nuk kishte ofruar ndonjë listë të gjësendeve që i kishin marrë prej objekteve.
6. Sa i përket bastisjes së shtëpisë, djali i parashtruesit të ankesës ishte arrestuar dhe ishte sjellë në stacionin policor në Prishtinë. Ai ishte liruar një (1) ditë më vonë, me datën 24 shtator 2009.
7. Gruaja e parashtruesit të ankesës e cila në atë kohë veç se ishte duke u mjekuar për arsye të shëndetit mendor, dhe dy vajzat e djalit të tij ishin tmerruar dhe traumatizuar nga kjo ngjarje. Së paku njëri prej fëmijëve dyshohet se ishte sulmuar fizikisht nga policët e EULEX-it.
8. Parashtruesi i ankesës ishte shtrirë në spital në Llapjesellë për shkak të përkeqësimit të gjendjes shëndetësore. Të dy mbesat ishin dërguar tek mjeku më 30 shtator 2009. Mjeku i kishte këshilluar që ato të dërgohen në Vranjë, në Republikën e Serbisë, në mënyrë që të shërohen nga trauma. Që prej atëherë gjendja e tyre nuk është e qëndrueshme, dhe ato ende kanë frikë që të mbesin vetëm në shtëpi apo ndaras nga prindërit e tyre.

### III. ANKESAT

9. Parashtruesi i ankesës pohon se policët e EULEX-it kanë kryer krime të rënda dhe kanë shkelur të drejtat e tij të njeriut gjatë bastisjes së tij dhe arrestimit të djalit të tij. Ngjarjet e datës 23 shtator 2009 kanë shkaktuar shumë vuajtje në familjen e tij dhe veçanërisht fëmijët janë ende të prekur.

#### IV. LIGJI

10. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Rregullën 29 të Rregullores së Punës (RrP).
11. Paneli mund të shqyrtojë vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në drejtës, polici dhe dogana, siç përcaktohen në Rregullën 25, paragrafi 1 i Rregullores së Punës.
12. Paneli konstaton se veprimet e ndërmarra nga Policia e EULEX-it gjatë arrestimit të djalit të parashtruesit të ankesës dhe më pas të bastisjes së shtëpisë më 23 shtator 2009 mund të konsiderohen nga Paneli se bien në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it.
13. Sidoqoftë, në përputhje me Rregullën 25, paragrafi 3 të Rregullores së Punës<sup>1</sup> ankesat duhet të dorëzohen brenda tre muajve nga data kur Paneli mund t'i pranoj ankesat (9 qershor 2010), apo brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së dyshuar, cila do që të jetë më e përshtatshme për parashtruesin e ankesës.
14. Kjo ankesë ishte parashtruar në Panel përafërsisht nëntëmbëdhjetë (19) muaj më vonë se data 21 prill 2011. Ankesa është dashur që të parashtrohej jo më vonë se data 9 shtator 2010. Prandaj, ankesa nuk e plotëson kriterin e pranueshmërisë të përcaktuar në Rregullën 29 të RrP-së.

#### PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI

*konstaton* se kjo ankesë është parashtruar në Panel jashtë afatit, i cili është përcaktuar në Rregulloren e Punës, dhe

*gjen* se ankesa është e pabazuar sipas Nenit 29 (d) të Rregullores së vet të Punës, dhe

#### SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor



Antonio BALSAMO  
Kryesues i Panelit

<sup>1</sup> Siç është shprehur në versionin në fuqi të datës 9 qershor 2010, në kohën kur është parashtruar kjo ankesë.

